




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Vitisë**  
Opština Vitina – Municipality of Viti  
*Drejtoria për Kulturë, Rrini dhe Sport*



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

|                             |            |            |          |
|-----------------------------|------------|------------|----------|
| Pratund - Prilijeno Nalozna |            |            |          |
| 14-01-2021                  |            |            |          |
| Nr. organiz.                | Num. llog. | Udh. d. d. | Vlera    |
| Org. broj                   | Num. llog. | Put. broj  | Vrednost |
| 12-052/01-16                |            |            |          |

2020

**RAPORTI I PUNËS**  
**I**  
**DREJTORISË**  
**PËR KULURË SPORT DHE RINI**

**JANAR – DHJETOR 2020**

12/13/2020

**Dejtori i Drejtorisë**

**Milot LALA**

## Përmbajtja

|                                                                                 |           |
|---------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>I. HYRJE</b>                                                                 |           |
| Përmbajta.....                                                                  | 2         |
| Obligimet e DKRS-së.....                                                        | 3         |
| Korniza Ligjore.....                                                            | 5         |
| <b>II. RAPORT NARRATIV</b>                                                      |           |
| Korniza ligjore dhe aktet tjera rregullative.....                               | 6         |
| Thirrja publike për etnitete publike për mbështetje financiare dhe anulimi..... | 7         |
| a). Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.....                                | 8         |
| b). Sektori Bibliotekës Publike Komunale.....                                   | 9         |
| c). Sektori i Arkivit Historik gjatë vitit 2020.....                            | 10        |
| d). Aktivitetet në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”.....       | 11        |
| Investimet kapitale.....                                                        | 11        |
| Bashkëpunimi me organizatat vendore dhe ndërkombëtare .....                     | 12        |
| Menaxhimi i kontratave.....                                                     | 13        |
| <b>III. RAPORT FINANCIAR</b>                                                    |           |
| Subvencionimi sipas përqindjes (%).....                                         | 13        |
| Paramasat dhe procedimi i procedurave tenderuese nga kodu Sh.M.....             | 14        |
| Publiciteti medial i aktiviteteve .....                                         | 14        |
| <b>V. INDIKATORËT E SUKSESIT.....</b>                                           | <b>15</b> |

**P.S.** Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS), pas paraqitjes së pandemisë Covid-19 u detyrua të vepronte sipas rekomandimeve të IKShPK për masat parandaluese nga 13 marsi. DKRS ka zbatuar masat nga IKShPK dhe Komiteti Emergjent Komunal për menaxhimin pandemisë Covid-19, në këtë kuptim aktivitetet e planifikuara kanë pësuar ndryshime me reduktime dhe anulime të aktiviteteve të planifikuara.

## **HYRJE**

### **Obligimet e DKRS-së**

4.1- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të saja në fushën e veprimtarisë, është përgjegjëse dhe obligohet:

44.1.1- Ushtron aktivitetet e planifikuara, duke udhëhequr me resurset (burimet) lokale, kulturore, të rinisë dhe të sporteve.

44.1.2- Propozon dhe përgatitë parallogaritë buxhetore të drejtorisë ,në kuadrin e organizatës buxhetore ,të administratës Komunale ,dhë të njejtën e bënë publike, si dhe përpilon rregullore për ndarje prioritare dhe proporcionale të buxhetit të sajë për fushat e veprimtarisë që mbulon.

44.1.3- Bënë organizimin dhe përkujdesjen për shënimin e datave me rëndësi dhe vlera të dëshmuara historike.

44.1.4-Organizon,debate ,tryeza me shtresat e shoqërisë civile dhe organet shtetërore më qëllim të avancimit,zhvillimit dhe promovimit, të fushës së kulturës, preokupimet, problematikën dhe aktivitetet e rinisë dhe të sporteve në të gjitha degët dhe disiplinat e tij.

44.1.5- Udhëheqë me përgjegjësi të lartë ligjore me arkivin Komunal dhe lëndën arkivore ,dhe përkujdeset për ruajtjen, konservimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë arkivore

44.1.6-Udhëheqë me shtëpinë e kulturës, kinemanë dhe bibliotekën Komunale dhe palestrat sportive ku titullar pronësie është Komuna e Vitisë.

44.1.7- Përpilon, rishikon punët dhe veprimet juridike të raporteve juridiko-civile kontraktuale në lidhje me objektet e kulturës, rinisë dhe sporteve.

44.1.8-I raporton Kryetarit të Komunës për përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorisë si dhe bashkëpunon me drejtoritë tjera të administratës Komunale dhe Kuvendin Komunal,si dhe organet e sigurisë në Komunë.

44.1.9-Përgatitë raporte të arsyetuara dhe të argumentuara kur kërkohet nga anëtarët e Kuvendit Komunal, apo KPF të Kuvendit ( në formë pyetje-interpelancë-kuvendare ) me miratim dhe autorizim të Kryetarit të Komunës.

44.1.10-Krijon relacione bashkëpunimi funksional dhe hierarkik me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe kërkon mbështetje për projektet e drejtorisë në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

44.1.11-Përkujdeset për sigurimin e resurseve njerëzore dhe materiale (financiare) për realizimin e programeve të rinisë.

44.1.12- Bënë licencimin e qendrave rinore dhe regjistrimin e grupeve, klubeve, ansambleve etj.

44.1.13- Kujdeset për trashëgiminë kulturore, historike dhe materiale të Komunës

(xhamitë, kishat, shkollat, shtëpitë e banimit ( të vjetra) dhe strukturat tjera që dëshmojnë histori-si burime materiale historike, dhe së bashku me MKRS dhe donatorë ,kujdeset për mirëmbajtjen dhe restaurimin e tyre në përputhje me identifikimet e kësaj pasurie kulturore në PZHU ,të Komunës së Vitisë .

44.1.14- Ushtron, promovon dhe nxitë bashkëpunimin me qytetet tjera të Republikës së Kosovës dhe me shtete tjera në përputhje me politikat e jashtme të shtetit të Kosovës, për të mundësuar integrim të mirëfilltë kulturash dhe këmbim përvojash në interes të zhvillimit të kulturës në përgjithësi dhe integrimin kulturor të rinisë tonë në diasporë

44.1.15- Respektimi, hulumtimi, përkrahja dhe ndihma për asociacione, klube , shoqata dhe hulumtimi i individëve me aftësi të posaçme kreative , në fushat e kulturës, sportit dhe mbështetja e tyre me transparencë të plotë dhe pa kurrfarë diskriminimi.

44.1.16- Bashkëpunon me drejtorinë e arsimit në lidhje me reformat dhe kushtet që mund t'i kenë të rinjtë (duke organizuar, gara, kuize dhe forma tjera të aktiviteteve kulturore shkencore dhe sportive.

44.1.17- Organizon ,anketa, seminare dhe trajnime të ndryshme, me qëllim të njoftimit ,promovimit dhe inkuadrimin të të rinjve kosovar në aktivitetet rinore evropiane dhe botërore.

44.1.18- Organizon fushata më rininë dhe me shoqërinë në përgjithësi për luftën kundër substancave psikotrope ( drogës ,duhanit ) dhe fushata tjera nga preventiva shëndetësore në luftën kundër –HIV, prostitucionit dhe dukurive tjera negative në shoqëri.

44.1.19- Ushtron edhe autorizime dhe kompetenca tjera në fushën e organizimit të punës në drejtori, krijimin dhe hartimin e akteve të brendshme për drejtorinë, si dhe bënë fletëparaqitjet disiplinore dhe fletëparaqitje tjera për nëpunësit e drejtorisë në rastet e shkeljeve të detyrave të tyre të punës dhe kodit të mirësjelljes në komisionin disiplinor, përmes udhëheqësit të personelit të shërbimit civil Komunal si dhe bënë vlerësimin e rezultateve në punë për shërbyesit civil të drejtorisë .

44.1.20- Ushtron edhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara me ligje të veçanta dhe akte nënligjore qendrore apo komunale, si dhe duke u bazuar në udhëzimet strategjike të Kryetarit të Komunës dhe të akteve të tij.

Neni 45

45.1- Të gjitha drejtoritë nga kreu 5 i këtij vendimi, respektivisht për të gjitha përgjegjësitë autorizimet dhe obligimet të përshkruara nga neni 18 e deri te neni 44 ,drejtorët dhe të gjithë shërbyesit civil në këto drejtori mbajnë të gjitha format e përgjegjësisë, për punët dhe detyrat e tyre, si dhe të gjitha drejtoritë nga neni 18-44 i këtij vendimi për punën e drejtorisë i raportojnë me raporte të rregullta 1.3.6. mujore dhe vjetore Kryetarit të Komunës.

Neni 46

46.1- Të gjithë shërbyesit civil për aktet e përpiluara dhe të hartuara të administratës komunale, mbajnë përgjegjësinë personale dhe profesionale, për aktet e tyre dhe të gjitha aktet e hartuara apo të përpiluara nga ata -zyrtarët administrativ aktet e veta i firmosin në anën e majtë të aktit – në fund të tij, kurse drejtori i firmos aktet e tilla dhe i vulos me vulën e drejtorisë në fund – në anën e djathtë të aktit.

Neni 47

47.1 –Obligohen të gjitha organet e administratës Komunale t'i zbatojnë me azhuritet dhe efikasitet të plotë të gjitha vendimet përfundimtare administrative ( aktet përfundimtare dhe të ekzekutueshme ) dhe gjyqësore.

47.2- Zbatueshmëria e pakundërshtueshme e vendimeve përfundimtare administrative dhe gjyqësore është parim imperativ për organet Komunale të administratës në Komunën e Vitisë.

Neni 48

48.1- Kryetari i Komunës mund të shfuqizoj çdo akt të drejtorive të administratës Komunale ,kur vlerëson së aktet e tilla janë në kundërshtim me ligjet pozitive në fuqi dhe me aktet tjera nënligjore të organeve qendrore dhe të Komunës së Vitisë, dhe kur me akte të tilla cenohen të drejtat e komuniteteve dhe te qytetareve të Komunës së Vitisë ( neni 58 shkronja b,g dhe k LVQL) si dhe të drejtat tjera nga marrëdhënia e punës të shërbyesve civil.

## Korniza Ligjore

DKRS gjatë vitit 2020 ka respektuar të gjitha Ligjet, Udhëzimet Administrative, rregulloret përkatëse në fuqi si dhe ka bërë hartimin dhe propozimin e dy rregulloreve të cilat janë miratuar nga Kuvendi Komunal i Komunës së Vitisë

1. Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e Qendrës Rinore **(01-013/373)**
2. Rregullore për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve **(01-013/1706)**

## Rregullore Komunale:

1. Rregullore për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha
2. Rregullore për Promovimin dhe Fuqizimin e Vullnetarizmit **(01-013/980)**
3. Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e KVRL-së **(01-013/1963)**
4. Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e Qendrës Rinore **(01-013/373)**
3. Rregullore për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve **(01-013/1706)**

## Ligje:

1. Ligji për Ansamblin Shtetëror të Këngëve dhe Valleve "Shota" dhe për Ansamble tjera **(Nr.03/L-056)**
2. Ligji për Arkivat Shtetërore **(Nr.04/L-088)**
3. Ligji për Trashëgiminë Kulturore **(Nr.02/L-88)**
4. Ligji për Bibliotekat **(Nr.04/L-097)**
5. Ligji për Administrimin e Punës në Zyrë **(Nr.04/L-184)**
6. Ligji i Punës **(Nr.04/L-212)**
7. Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës **(Nr.03/L-149)**

## Udhëzimet Administrative:

1. Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë **(Nr. 03/L-145)**
2. Udhëzim Administrativ për Punën vullnetare të të rinjve **(Nr.01/2016)**
3. Udhëzim Administrativ për Edukimin Joformal të të rinjve **(Nr. 04/2015)**
4. Udhëzim Administrativ për Licensimin e Shoqërive Sportive **(Nr.02/2015)**
5. Udhëzim Administrativ për Licensimin e Qendrave Rinore **(Nr.11/2010)**
6. Udhëzim Administrativ për Përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të KVRL-ve në Kosovë **(Nr.09/2010)**
7. Udhëzim Administrativ për pranimin-dorëzimin e Lëndës arkivore **(Nr.09/2007)**

## Memorandume Bashkëpunimi:

1. Komuna e Vitisë dhe Komiteti Olimpik i Kosovës
2. Komuna e Vitisë dhe UNDP – Projekti ReLOaD faza -II-të
3. Komuna e Vitisë dhe USAID/ Up to Youth
4. Komuna e Vitisë dhe Fondacioni Kosovar Trashëgimia Kulturore pa kufij, CHWB Kosova
5. Komuna e Vitisë dhe Caritas Kosova

## **Thirrja publike dhe anulimi i mbështetjes financiare të entiteteve publike pas shfaqjes së pandemisë Covid-19 në Viti**

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport pas paraqitjes së pandemisë SARS "Covid 19" në mbar Botën, ndërpreu aktivitetet e saja nga 13 marsi 2020 deri me 8 qershor 2020 kur drejtoria u rikthye me kapacitetet e plota të punës.

Komisioni i emëruar nga Kryetari i Komunës me datën: 02.03.2020 me Nr. protokolli 02-035/02-211. Kryetari i Komisionit ka përgatitur dosjen e aplikimit për OJQ-të dhe Thirrjen publike të datës 05.02.2020 me Nr. Protokolli 02-060/01-97.

Pas thirrjes publike OJQ-të dorëzuan aplikacionin, pas skadimit të afatit nga thirrja publike kryetari i komisionit ka terjak dosjet e aplikimit nga zyra e protokollit dhe ka përgatitur dosjet për komisionin vlerësues. Në kohën kur duhej ftuar komisionin vlerësues u paraqit pandemia "Covid 19" dhe njëkohësisht u ndërpreu të gjitha veprimet e komisionit. Kryetari i komunës pas futjes së komunës në karantinë ka thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme të kuvendit komunal ku janë ndarë një buxhet prej 100,000 € për menaxhim të pandemisë "Covid 19"

Komisioni pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme i propozoj kryetarit të komunës ANULIMIN e thirrjes publike për mbështetjen financiare të entiteteve publike. Në bazë të konsultave me zyrtarë të financave, nga pandemia buxheti nga të hyrat vetanake është shumë i vogël nga dhe nuk mund të llogaritët mjetet e nevojshme për financimin e projekteve të OJQ-ve .

Vendimi për ANULIMIN e thirrjes publike u publikua me 20 korrik 2020 ne nr, protokolli 02-035/02-651

Komuna e Vitisë, Zyra e kryetarit në përputhje me Rregulloren mund të merr vendime për mbështetje financiare nga kodi buxhetor i subvencioneve deri në 5% e buxhetit të drejtorisë nga 38,000€.

Sipas Rrregulloresne Fuqi Memorandumet para Rregullores mund të mbështeten financiarisht deri në fund të periudhës së përfundimit të Memorandumit. Në këtë kuptim janë ndarë subvencione për 2 shenjëtarët bazuar në Marrëveshjen e Komunës së Vitisë me Komitetin Olimpik të Kosovës e cila janë mbështetur financiarisht deri në gushti 2020 me vlera prej 100€ për secilin garues në muaj.

### **RAPORT NARRATIV**

Sektorët DKRS-së pas paraqitjes së pandemisë Covid-19 kanë anuluar agjendat e aktiviteteve sipas rekomandimeve të IKSHPK-se për masatë ndërmarrë antiepidemike. Në këtë kuptim drejtoria duke qenë në karantinë komuna e Vitisë, është ndërprerë puna për më tepër se dy muaj më pastaj është publikuar me staf esencial me reduktim apo anulim total të aktiviteteve. Në përputhje me masatë dhe udhëtimet e IKSHPK janë mbajtur aktivitetet e poshtëshënuara në vijim:

**a). Sektori për Kulturë, Rini dhe Sport: Përmbledhja e shkurtër e aktiviteteve gjenerale**

- 16 janar: Ekspozita e artit pamor me temë "Frymë Lirie"
- 20.01.2010 – Fillimi i renovimit të objektit për Muzeun e qytetit
- 31.01.2020 – Lauretat e vitit 2019
- 14.02.2020 - ekspozitë në kuadër të projektit "Iniciativa për shkëmbim kulturor ndër-kufitar (MAKS FORUM)
- 14.02.2020 - Orë letrare në shënim të 12 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës
- 14.02.2020 – Ligjërat me të rinjët, tema "Rinia dhe shtet ndërtimi"
- 17.02.2020 - 17 shkurti - Dita e pavarësi së Kosovës - Organizimi i garave ndërkombëtare në atletikë në bashkëpunim me Federatën e Atletikës të Kosovës. Diploma në disiplinat: Fatosat (M) - 400m, Yllkat (F) – 400m, Pionier të rinj(F) – 800 m, Pioniere të reja (M)– 800m, Pionier (M) – 2 km, Pioniere (F) – 2 km, Junior (M) – 6 km, Juniorët (F) 3 km, Senior (M) 10 km, Senioret (F) 10 km, Veteran (M) – 6 km., eterane (F) 6 km
- Homazhe te varrezat e dëshmorëve
- 27 shkurt 2020
- Salla e kinemasë - shfaqja filmike për fëmijë
- 13 shkurt shfaqja e "SARS COV 19"
- ANULIMI I GJITHA AKTIVITETEVE PUBLIKE dhe stafi pushon punën NGA 16.03.2020 – 01.06.2020
- 24 mars.2020 – Dita e bombardimeve te NATOS
- 26.03.- 14. 06. 2020 Homazhe për dëshmoret veç e veç, homazhe për epopenë e UCK-së, Homazhe Dita e dëshmorëve, homazhe Dita e Çlirimit, etj,...
- 22.04.2020 – Dita e Tokës
- 03.05.2020 – Homazhe obeliskut "Kerim Lewton" klubit të gazetarëve "Kerem Lawton",
- 05.03.2020 – vizitë e studentëve Francezë ne Viti
- 05.05.2020 – Vitia shënoi 5 Qershorin- Ditën Botërore të Mjedisit
- 01.06.2020 – Dita Ndërkombëtare e fëmijëve
- 02.06.2020 – Komuna e Vitisë nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi për realizim të projektit "Up To Youth"
- 05.06.2020 – 5 Qershorin- Ditën Botërore të Mjedisit
- 14.06.2020 – 14 Qershorin- Ditën e Çlirimit
- 02. korrik.2020 - Manifestimi tradicional kulturorë dhe sportiv "2 korriku" Beguncë turneu i i futbollit i anuluar ndërsa është bërë organizimi simbolik i turneut me 6 ekipe pjesëmarrëse dhe performancëe e Klubit të Gjimanstikë. Ekipet pjesëmarrëse 2 ekipe KFOR, 1 Komuna, 1 FKS 1 Policia. Loja e parë KFOR 1 - KOMUNA , FSK – Plicia e Kosvës, Veteranet – KFOR 2.
- 03. korrik 2020 - HIKING për nder të pavarësisë së ShBA-ve shtegu Zhiti-Ballancë-Tërpezë
- 17.07.2020 - Vizita e Ministers së MKRS-se Prishtine
- 12 gushti – Dita Botërore e Rinisë e shënuar nga KVRL
- 11 shtatori – Dita e sulmeve terroriste ne Amerikë HOMAZHE sheshi Richarde Holbrooke
- 28 shtatopri – Dita e Rinisë "Gursel e Bajram Sylejmani", organizimi i garave sportive: Gara në KARAOKE, ndeshje miqësore në Futboll veteranet Kfv. Vitia – Ffv. Ferizjai, Hiking shtetgtim ne malet e jezercit "20 vet pas shtigjheve te heronjve Gursel e Bajram Sylejmanit", Homazhe

- 30.09.2020.– Java Evropiane e Sportit – aktivitete sportive me nxënës të shkollave fillore
- Takimet e Dom Mikel tarabolluzit - ONLINE
- 02.10.2020 - Ndeshje miqësore - KFOR/Britanik – Komuna & Policia – FSK-ja, KFOR - Veteranet
- 04.10.2020 – Dita ndërkombëtare e cjes – Klubi i Hikingut “Angros” – Viti
- 15.10.2020 – Përrurimi i fushës sportive në Ramijan si dhe zhvillimi i ndeshjeve miqësore në futboll të vogël KFOR - Komuna
- 30.10.2020 – Renovimi i muralit në Shtëpin e Kulturës nga ShAF “Gursel Sylejmani”
- 29.10.2020 - Dita e Kulturës Amerikane. Agjenda: Homazh bustit Richard Holbrook, Ngritja dhe Ulja e Flamurit Amerikan Kori i qytetit. Trumpet Art Ramadan, Ekspozitë me fotografi nga aktivitetet e Drejtoris me KFOR Amerikan 2017-2020, Ora e pictures për fëmijë, tema: Si duket Amerika nga perspektiva e fëmijëve kl,5-9, Muzik Instrumentale, Kori i qytetit, Karaoke - Kori i qytetit & KFOR-i Amerikan, Filma artistikë, mbrëmje muzikore, Kori i qytetit, Fast Food nga zgara, Ndezja e fishekzjarreve
- 26.11.2020 - Thanksgiving day – Dita e falemderimeve amerikane – Online, takim me KFOR-in
- 28 nëntori – Dita e Flamurit kombëtar, Homazhe te varrezat e dëshmoreve
- 28.11.2020 - Përrurimi i librave të Prof. Isak Shemës në këndin e Bibliotekës për të rritur, dhurata e profesorit
- 05.12.2020 – Mbajtje e festivalit për fëmijë “Cover Fesst”

#### **b) Sektori Bibliotekës Publike Komunale**

Gjatë vitit 2019, Biblioteka Publike Komunale ka zhvilluar të gjitha aktivitetet e veta konform Ligjit dhe planit të punës për vitin 2019, duke kryer detyrat e veta dhe, duke qenë në shërbim të lexuesve, duke u angazhuar në ngritjen e nivelit të shërbimeve, me qëllim që qytetarëve dhe lexuesve të rregullt të ju ofroj kushte dhe shërbime cilësore.

Aktivitetet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe, janë përfshirë në këtë raport, sipas rëndësisë së aktiviteve. Është me rëndësi të përmendet angazhimi i stafit të bibliotekës ka qenë në nivel. Kështu që performanca e tyre në punë ka qenë e kënaqshme dhe angazhimi i tyre ka qenë në funksion të përmirimit të shërbimeve për lexuesit, që njëherit është edhe mision parësor i Bibliotekës, ofrimi cilësor i shërbimeve.

#### **Autorët të cilët dhuruan bibliotekës botimet e tyre:**

**Esat Kamberi**, dhuroi librin: KATALOGU I FONDIT ARKIVOR „ESAT KAMBERI” (një ekzemplarë)

**Bardh Frangu**, dhuroi dy tituj: UDHËT E ËNDRRAVE (pesë ekzemplarë) dhe ÇELËSI I ZONJËS MERI ( tre ekzemplarë )

**Besjana I. Rexhepi dhe Kastriot I. Vesalaj** , dhuruan librin me titull : PRINDËRIMI DHE EFEKTET E TIJ NE MESIMDHËNIEN BASHKËKOHORE ( libër Socio – Pedagogjik, dy ekzmp.)

**Hamit F. Gërguri**, dhuroi 13 tituj me nga një ekzemplarë

**Zymrie Salihu**, dhuroi librin me titull: GJENERATË E SFIDAVE TË KOHËS,( pesë ekzemplarë)

**Jusuf Buxhovi** – Prishtinë, dhuroi dy tituj:

DARDANIA: ANTIKA, MESJETA (dhjetë ekzemplarë)

MONA ( pesë ekzemplare)

**Ramiz Misini** – Devajë , dhuroi librin me titull: DEVAJA NEPER SHTJELLAT E KOHES, (nëntë kzemplarë)

**Lah Jashari** – Smirë, dhuroi katër tituj:

1. *PERGAMENË E DJEGUR – Çun Lajçi, ( dy ekzemplarë)*
2. *BASTARDËT - Çun Lajçi, ( një ekzemplarë)*
3. *KUR FRYJNË ERNAT - Çun Lajçi, (një ekzemplarë)*
4. *BUBULINË, TI LETËR E PASHKRUEME, Çun Lajçi, ( një ekzemplarë)*

**Lush Isufaj** – Prishtinë, dhuroi librin me titull: *TË JETOSH VERTIKALISHTË, ( tre ekzemp.)*

**Prof. Dr. Isak Shema**, i dhuroi Bibliotekën e tij personale Bibliotekës Komunale të Qytetit – Viti, ku me rastin e festave të nëntorit, kemi bërë promovimin e Këndit të Bibliotekës së Prof. Dr. Isak Shema.

Biblioteka Publike Komunale, është mirënjohëse për gjithë ata që dhurojnë botimet e tyre por edhe ata të cilët japin donacion

Ne këtë vit, fondi i Bibliotekës u pasurua nga MKRS dhe autoret nga MKRS, 61 tituj me 340 ekzemplarë, ndërsa nga autoret, 27 tituj me 61 ekzemplarë Gjithsejtë: 88 - TITUJ me 401 – EKZEMPLARË

### *Regjistri i lexuesve sipas numrit për vitin 2020*

| <i>Bibliotekat</i>                        | <i>Amë per të vegjlit</i> | <i>Amë për të rritur</i> | <i>Dega Pozheran</i> | <i>Dega Sllatinë e Epërme</i> | <i>Gjithsejt</i> |
|-------------------------------------------|---------------------------|--------------------------|----------------------|-------------------------------|------------------|
| Numri i përgjithshëm i anëtarëve          | 203                       | 132                      | 168                  | 162                           | 665              |
| Numri i përgjithshëm i librave të lexuara | 1104                      | 1759                     | 1056                 | 1163                          | 5082             |

*Verejtje : Sikurse e kemi cekur edhe më lartë, se në këtë vit nuk është punuar rregullisht dhe për këtë arsye kemi një statistikë shumë më të vogël të lexuesve, se në vitet tjera.*

### **c) Sektori i Arkivit Historik gjatë vitit 2020**

Arkivi Historik Komunal ka për qëllim promovimin dhe avancimin e punës rreth mirëmbajtjes në përgjithësi të lëndës arkivore që gjendet nën menaxhimin e Arkivit , dhënies së këshillave për fondkrijuesit në procesin e klasifikimit, ruajtjes, asgjësimit dhe dorëzim-pranimit të lëndës e cila ka afat të përherëshëm të ruajtjes në Arkiv. Për keto veprime të lartpërmendura Arkivi Historik funksionon dhe ka një mbështetje me bazë ligjore të qartë e të krijuar nga institucionet qendrore për veprimtarinë arkivore. Ndër të tjera Arkivi Historik zbaton ligjin nr.04/L-088 për Arkiva Shtetërore të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe dy udhëzimet përcjellëse, bazë për trajtimin e lëndës arkivore si; Udhëzimi Administrativ nr.08/2007 për Përzgjedhjen e Lëndës Arkivore dhe Asgjësimin e Materialit të pavlershëm Regjistraturik dhe Udhëzimin Administrativ nr.09/2007 për Dorëzim-Pranimin e Lëndës Arkivore. Arkivi Historik punon në planin e brendshëm duke u bazuar në funksionimin e tri referateve kryesore si: Shërbimi i brendshëm që ka për detyrë rregullimin e lëndës në Arkiv, shërbimi jashtëm që merret me kontrollimin e lëndës tek fondkrijuesit dhe puna me palë apo dhënia në shfrytëzim e lëndës për nevoja private dhe zyrtare.

Këtë vit është bërë evidentimi dhe klasifikimi i tërë materialit arkivor në kuadër të Arkivit Historik.

| <b>Kërkesat të shqyrtuara</b> | <b>Kërkesat të realizuara</b> | <b>Kërkesat të Refuzuara</b> |
|-------------------------------|-------------------------------|------------------------------|
| <b>75</b>                     | <b>57</b>                     | <b>18</b>                    |

#### d) Aktivitetet në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”

Hapsirat e Qendrës së Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani” gjatë vitit 2020, janë shfrytëzuar nga Institucionet Komunale, Organizatat tjera qeveritare, Organizata Jo-Qeveritare vendore dhe ndërkombëtare, Partitë Politike për aktivitetet e tyre përkatëse.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur numri i aktiviteteve sipas muajve:

#### Statistika tabelare e aktiviteteve për periudhën Janar- Dhjetor/2020

| Pasqyra tabelare e aktiviteteve të mbajtura në Shtëpinë e Kulturës, në periudhën janar – dhjetor / 2019 |                               |        |           |                                                    |                       |                                |                     |            |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|--------|-----------|----------------------------------------------------|-----------------------|--------------------------------|---------------------|------------|
|                                                                                                         | Institucio<br>net<br>komunale | OJQ-të | Ekspozita | Shfaqje filmi<br>-Dokumentar<br>-Teatri<br>-Baleti | Promovim<br>e librare | Personat<br>privat<br>(Libri). | Partitë<br>politike | Gjithsej   |
| Nr.i aktiviteteve<br>për vitin<br>kalendarik<br>Janar-dhjetor                                           | 25                            | 151    | 2         | 11                                                 | 7                     | 2                              | 0                   | 198        |
| Nr. i<br>pjesëmarrësëve                                                                                 | 800                           | 1,303  | 80        | 800                                                | 150                   | 80                             | 0                   | 3,213      |
| Nr. i aktiviteteve<br>gjatë vitit 2020                                                                  | <b>Gjithsejt .....</b>        |        |           |                                                    |                       |                                |                     | <b>198</b> |

#### INVESTIMET KAPITALE

| Përshkrimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Investimet kapitale në infrastrukturë - vazhdimi i punës kontinuele të projekteve kapitale:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Palestra e sportit në Drobesh</li> <li>2. Stadiumi në Vitisë</li> <li>3. Stadiumi “Ibrahim Kurteshi “ në Pozheran</li> <li>4. Stadiumi ndimës i KF “Vllazniaa” nga Pozheranit</li> <li>5. Stadiumi në Sodovin J.</li> </ol>                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <i>Investimet kapitale në infrastrukturë fushat sportive</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fusha e futbollit ne Skifteraj e shtruar me gomë</li> <li>2. Fusha e futbollit në Smirë e shtruar me gomë</li> <li>3. Fusha e sportive multifunksionale në Radivojcë e shtruar me gomë</li> <li>4. Fusha sportive multi funksionale në Ramijan e shtruar me gomë</li> <li>5. Fusha sportive multifunksionale me rrethoja metali dhe ndriqim në Kabash</li> <li>6. Fusha sportive multifunksionale me rrethoja dhe ndriqim në Lubishtë</li> <li>7. Fusha sportive multifunksionale me rrethoja dhe ndriqim në Drobesh</li> </ol> |

### **Investimet kapitale në infrastrukturë kulturore**

1. Renovimi i shtëpisë së kulturës- projekt në vashdimësi nga 2019
2. Renovimi i objektit për muze komunal në Viti
3. Amfiteatri veror në hapsirat e Shkolles se pare shqipe në Stubël të Epërme

### **Prokjekte të bashkëpunimit me organizata dhe institucione vendore dhe ndërkombëtare për rini**

1. Caritas Kosova projekti "Jour Job"
2. Projektin Up to Youth të financuar nga USAID
3. Korpusi i Paçes – vullnetarizmi dhe ndima komunitetit
4. Projekti: CwHB Kosovo (BE), restaurimi i objektit për Muzeun komunal

## **BASHKËPUNIMI ME FEDERATAT/ORGANIZATAT VENDORE DHE ORGANIZATA TJERA**

- I. Bashkëpunimi me MKRS-ne
- II. Bashkëpunimi me Federatën e Atletikës së Kosovës per organizimin e manifestimit sportive "Vrapimi I pavarësisë.
- III. Bashkëpunimi me Federatën e Futbollit të Kosovës (FFK)
- IV. Bashkëpunimi me Komitetin Olimpikë të Kosovës për organizimin e panairit të klubeve sportive
- V. Bashkëpunimi me Federatën e Shahut të Kosovës për organizimin e turneve në Shahë
- VI. Bashkëpunimi me Federatën e Pingpongut të Kosovës për organizimin e turneve në pingpong
- VII. Bashkëpunimi me Shoqatën e motoristëve "Veteranet e UÇK-së" nga Kosova
- VIII. Bashkëpunimi me Shoqatën e motoristëve "Kastriotet" nga Ferizaj.
- IX. Bashkëpunimi me Caritas Kosova Jour Job
- X. Bashkëpunimi me USAID-in projekti Up to Youth
- XI. Komuna e Vitisë dhe UNDP – Projekti ReLoaD faza -II-të
- XII. Bashkëpunimi me OJQ-te lokale

### **MIRËNJOHJE**

FEDERATA E ATLETIKËS SË KOSOVËS PËR KOMUNËN/SPORTIN PER ORGANIZIMIN E MANIFESTIMIT SPORTIV KOMBËTAR "VRAPIMI I PAVARËSISË" ME 17 SHKURTME PJESËMARRJE TË ATLETVE NGA KOSOVA, SHQIPERIA, DHE MAQEDONIA

### **BASHKËPUNIMI ME KFOR-IN AMERIKAN DHE BRITANIK**

- I. Bashkëpunimi me KFOR-in Amerikan në bashke organizimin e aktiviteteve: Sigurisë, mjedisit, shëndetësisë, sportit, rinisë, kulturë, etj.
- II. Bashkëpunimin me KFOR-in Britanik në ndeshjet miqësore të ndeshjeve të futbollit

### **BASHKËPUNIMI ME POLICIN E KOSOVËS DHE FSK-në**

- I. Bashkëpunimi me POLICIN e KOSOVËS - pjesëmarrja në aktiviteteve sportive, kulturore dhe rinore
- II. Bashkëpunimi me FSK-në – pjesëmarrja në aktivitete sportive (turne të futbollit dhe hiking)

## MENAXHIMI I KONTRATAVE KOMUNALE PËR SHËRBIME DHE MALLARA

### Përshkrimi i kontratave:

1. Kontrata për shërbime të transportit publik
2. Kontrata për shërbimet e zërimit
3. Shërbimet e furnizimit me rekuizitë sportive
4. Shërbimet për ndriçim profesional
5. Etj.

### FNANCAT E DKRS-së


Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport pas anulimit të Thirrjes publike përr mbështetjen finaaciare të OJQ-ve, dhe shfaqjes së pandemisë Covid-19 dhe anulimit të thirrjes publike. DKRS ka kryer obligimet kontraktuale sipas Memorandumit me KOK per bursa per 2 garues të reprezentacionit të Kosovës në Shenjtari ( Drilon Ibrahim dhe Uratë Rama). Rrjedhimisht është shpenzuar buxheti i drejtorisë nga kodi buxhetor i Shërbimeve dhe Mallrave.

Në dy grafikat janë paraqitur shpenzimet e DKRS-së sipas raporteve të drejtorisë së financave me shumën totale të dy kategorive buxhetore si dhe tabela e dyte me poshtë janë paraqitur përqindjet e shpenzimeve në dy kategorit buxhetore

### Shpenzimet e DKRS-së 2020



### Përqindja e shpenzimeve të DKRS-së në dy kategoritë buxhetore: Subvencione dhe Shërbime e Mallra



## PËRGATITJA E PARAMASAVE DHE PROCEDURAVE TENDERIMI PËR SHËRBIME DHE MALLRA

| Nr. | Përshkrimi i paramasave                                                                                     | Procedurat tenderuese |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|
| 1   | Paramasa e shërbimeve grafike                                                                               | Në procedurë          |
| 2   | Paramasa e shërbimeve të zerimit                                                                            | Në shërbim            |
| 3   | Paramasa e shërbimit rekuizita sportive                                                                     | Në procedurë          |
| 4   | Paramasa e shërbimeve të transportit                                                                        | Në procedurë          |
| 5   | Paramasa e pajisje të zërimit për kino sallë                                                                | Në procedurë          |
| 6   | Paramasa e shërbimeve për ndriçimin profesional                                                             | Në shërbim            |
| 7   | Paramasa për transmetime publike të aktiviteteve dhe kuvendit                                               | Në procedurë          |
| 8   | Paramasa për YPS për kino aparaturë                                                                         | Në procedurë          |
| 9   | Paramasa për kamera të sigurisë për shtëpi të kulturës                                                      | Në procedurë          |
| 10  | Paramasa për mini muzeun dhe konservim të pajisjeve të dëshmoreve dhe aparatura e vjetër e kinemas          | Planifikime           |
| 11  | Riparimi i rrjetit elektrikë kino kabinë dhe aktivizimin e elektromotorëve me perde të kinemasë dhe teatrit | Planifikime           |

### PUBLICITETI MULTI MEDIAL

- Transmetimi dhe publikime të aktiviteteve në televizionin lokal "Plus TV" si dhe televizionet tjerë qendrorë me frekuencë nacionale në platformat e ndryshme
- Përgatitja teknike e Vjetarit: Dizajni, faqosja, fotografit përmbajtja nga aktivitetet, dhe publikime virtual
- Faqja zyrtare në rrjetin sociale Facebook:  
<https://www.facebook.com/profile.php?id=100008715822123>



## INDIKATORËT E SUKSESIT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në vazhdimësi bënë rishikimin dhe analizat e politikave publike ku vlerëson punën e bërë, opinionet e qytetarëve, hulumtimet nga matja e barometrit të rezultateve nga organizatat të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

- I. Konsultimi dhe pjesëmarrja e publikut në vendim'marrje
- II. Transparenca
- III. Pjesëmarrja e grupeve Formale dhe Joformale dhe e qytetarëve në aktivitete si dhe në implementimin e aktiviteteve.
- IV. Publiciteti multimedial i informimit të publikut
- V. Pasqyrimi i kronikave dhe transmetimeve të drejtpërdrejta televizive për qytetarë nga aktivitetet
- VI. Prezantimi i aktiviteteve për opinionin publik përmes TV, Radiove, Rrjeteve sociale, faqeve zyrtare të internetit, etj.
- VII. Shikueshmëria e video materialeve të aktiviteteve të drejtorisë të transmetuara në televizion dhe në arkiv të televizionit lokal "Plus TV".
- VIII. Informimi dhe komunikimi virtual me publikun përmes internetit veçanërisht faqet zyrtare të informimit si dhe rrjeteve sociale nën menaxhimin zyrtar
- IX. Qasja e qytetarëve në informata dhe organizatave të ndryshme për qasje në dokumentit zyrtare.
- X. Kçja e grupeve vullnetare në aktivitete.
- XI. Vlerësimi i qytetarëve për aktivitetet dhe punën e Drejtorisë.
- XII. Aplikimi i rregulloreve nga MF. për mbështetje financiare të entiteteve publike
- XIII. Formimi i OJQ-ve të reja sportive dhe rinore (dy klube sportive dhe një OJQ rinore )

Viti – Janar/ 2021

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport  
Drejtues i Drejtorisë

Milot LALA

